# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8388
E mërkurë, 16 shtator 2026
Çmimi 0. 50 €


## Zgjedhjet dhe vonesat institucionale në Kosovë "pengojnë agjendën" me ShBA-në FAQE 4




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


# ÇLIRIMTARË, KOSOVA JU PRET



Pas gati gjashtë vjetësh paraburgim në Hagë, sot (e mërkurë) populli i Kosovës pret me emocione të forta verdiktin për katër ish-krerët e UÇK-së. Qytetarët presin lirimin e plotë të të gjithë udhëheqësve të UÇK-së dhe kthimin e tyre në Kosovë. Shumica e komunave kanë organizuar hapësira publike ku qytetarët do të mund ta ndjekin drejtpërdrejt shpalljen e aktgjykimit, duke vendosur ekrane të mëdha në sheshe dhe ambiente të hapura. Ndërkaq, qytetarë të shumtë, përfaqësues të medieve, bashkëluftëtarë dhe bashkatdhetarë janë nisur drejt Hagës, për të qenë sa më pranë këtij momenti të rëndësishëm dhe historik për Kosovën

## AKTUALE




### KDI-ja: KATËR ÇËSHTJE KUSHTETUESE MBETEN TË HAPURA EDHE PAS KONSTITUIMIT TË KUVENDIT F. 2

### SELF KRITIKON HAGËN, SHPRESON QË "PARAGJYKIMET POLITIKE" TË MOS NDIKOJNË NË VENDIMIN PËR ÇLIRIMTARËT F. 3

### VDIQ FLORA BROVINA, LA GJURMË TË PASHLYESHME NË HISTORINË E KOSOVËS DHE TË SHQIPTARËVE F. 7

## EKONOMI



### AKB-ja NË FORUMIN EKONOMIK TË OBT-së, AGIM SHAHINI THEKSOI RËNDËSINË QË KOSOVA TË JETË MË AKTIVE NË EKONOMINË GLOBALE F. 8

## SPORT



### PRISHTINA DISKUTON ME IZRAELIN PËR SIGURINË DHE GATISHMËRINË PËR LOJËRAT MESDHETARE 2030 F. 10


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

# KDI-JA: KATËR ÇËSHTJE KUSHTETUESE MBETEN TË HAPURA EDHE PAS KONSTITUIMIT TË KUVENDIT

"Afati kushtetues për konstituimin e Kuvendit përfundoi më 7 gusht dhe i njëjti u shkel. Tash duhet të sqarohet çfarë pasoje juridike prodhon kjo shkelje, nëse mund të vazhdohet procesi pas skadimit të afatit dhe, nëse po, mbi cilat rregulla do të duhej të ndodhte kjo. Lënia pezull e kësaj çështje u krijon hapësirë aktorëve politikë që edhe në legjislaturat e ardhshme ta përshtatin kohëzgjatjen e konstituimit me marrëveshjet dhe kalkulimet e tyre", tha Eugen Cakolli nga Instituti Demokratik i Kosovës gjatë një konference për medie

**Prishtinë, 15 shtator** - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka mbajtur të martën konferencë për medie, në të cilën ka paraqitur analizën "Konstituimi i Kuvendit pas skadimit të afatit kushtetues".
Analiza trajton katër çështje të evidentuara gjatë procesit të fundit konstituiv, përfshirë pasojat e tejkalimit të afatit 30-ditor, kufijtë e së drejtës së propozimit, shkeljen e afatit 48-orësh për ndërprerjen e seancës dhe ushtrimin e kompetencave nga kryesuesi i përkohshëm.
Gjatë prezantimit Eugen Cakolli theksoi se pas konstituimit të Kuvendit dhe votimit të qeverisë më 13 shtator, vëmendja është përqendruar te funksionimi i institucioneve të reja.
Sidoqoftë, sipas tij, çështjet kushtetuese të hapura gjatë këtij procesi kërkojnë trajtim edhe në këtë fazë, për shkak të pasojave për legjislaturën aktuale dhe rrezikut të përsëritjes së bllokadave në të ardhmen. "Afati kushtetues për konstituimin e Kuvendit përfundoi më 7 gusht dhe i njëjti u shkel. Tash duhet të sqarohet çfarë pasoje juridike prodhon kjo shkelje, nëse mund të vazhdohet procesi pas skadimit të afatit, dhe nëse po, mbi cilat rregulla do duhej të ndodhte kjo. Lënia pezull e kësaj çështje u krijon hapësirë akterëve politik që edhe në legjislaturat e ardhshme ta përshtatin kohëzgjatjen e konstituimit me marrëveshjet dhe kalkulimet e tyre", tha Cakolli.




Ai rikujtoi se jurisprudenca kushtetuese e lidh respektimin e afatit me përfundimin e konstituimit. Për këtë arsye, KDI kërkon që Gjykata Kushtetuese t'i përcaktojë efektet e tejkalimit të tij, përfshirë ndikimin e mundshëm në procedurat dhe aktet pasuese.
Në anën tjetër, Vullnet Bugaqku trajtoi të drejtën e grupit më të madh parlamentar për propozimin e kryetarit të Kuvendit. Mungesa e propozimit në seancat e gushtit, sipas analizës, ngriti pyetjen se si zbatohet kjo e drejtë përballë detyrimit të Kuvendit për t'u konstituuar brenda afatit. "Gjykata duhet të sqarojë nëse e drejta e propozimit mund të shterohet, në çfarë rrethanash, kush e konstaton këtë dhe si vazhdon procedura. Deputetët kanë nevojë ta dinë paraprakisht rrugën institucionale për rastet kur propozimi mungon ose procesi mbetet vazhdimisht i bllokuar", u shpreh ai.
Më tutje, u paraqitën këndvështrimet për ndërprerjen e seancës dhe rolin e kryesuesit të përkohshëm. U theksua se ndërmjet vazhdimeve të 8 gushtit dhe 9 shtatorit kaluan 32 ditë, duke shkelur edhe kufirin maksimal prej 48 orësh të përcaktuar në Rregulloren e Kuvendit. Në këtë drejtim u potencua nevoja që të sqarohet kush ka përgjegjësi të veprojë në atë moment dhe përmes cilës procedurë deputetët mund ta sigurojnë vazhdimin e seancës.
Lidhur me kryesuesin e përkohshëm ai rikujtoi se neni 9(2) i Rregullores parashikon zëvendësimin në rast mungese ose refuzimi. Çështja që kërkon sqarim është zbatimi i këtij mekanizmi në rrethana të mosveprimit të zgjatur, respektivisht kur ky mosveprim mund të konsiderohet refuzim. Duke qenë se roli i kryesuesit të përkohshëm shërben vetëm për ta mundësuar konstituimin, duhet të parashihen modalitete që i tërë procesi të mos varet apo kushtëzohet nga veprimi i një deputeti.
KDI-ja kërkoi që palët e autorizuara t'i shtrojnë këto çështje për shqyrtim kushtetues, përmes kërkesave që përmbushin kushtet dhe afatet procedurale. Përcaktimi i pasojave juridike të shkeljeve, përfshirë vlerësimin e akteve pasuese, i takon Gjykatës Kushtetuese.
Kësaj të fundit KDI i bën thirrje që kërkesat eventuale lidhur me këtë proces t'i trajtojë me përparësi dhe në procedurë të përshpejtuar, duke respektuar afatet procedurale të zbatueshme. Urgjenca buron nga fakti se Kuvendi dhe Qeveria tashmë po ushtrojnë kompetencat e tyre, ndërkohë që pasojat juridike të shkeljeve gjatë konstituimit mbeten të pasqaruara. Çdo vonesë në shqyrtim e zgjat pasigurinë edhe për vendimet që këto institucione marrin gjatë kësaj periudhe.

# BE-ja THOTË SE QËNDRON PËRKRAH SOVRANITETIT DHE INTEGRITETIT TERRITORIAL TË BOSNJËS

**Bruksel, 15 shtator** - Bashkimi Evropian (BE) ka thënë të martën se e mbështet "fuqishëm" sovranitetin, rendin kushtetues dhe integritetin territorial të Bosnjë-Hercegovinës pas deklaratave të një kryetari komunal në Republikën Sërpska për bashkimin e këtij entiteti me Serbinë.
Në prag të festimit të Ditës së Unitetit, Lirisë dhe Flamurit Kombëtar Serb, kryetari i Banjallukës, Drashko Stanivukoviq, shkroi në Facebook se "Republika Sërpska dhe Serbia janë një". "Një popull dhe një flamur. Uniteti, harmonia, harmonia dhe liria, janë fjalë të shenjta serbe për të cilat duhet të përpiqemi, pafundësisht, deri në qëllimin përfundimtar", tha Stanivukoviq.
Bashkimi Evropian në Bosnjë kujton se "thirrjet e njëanshme për ndryshime në kornizën kushtetuese, qoftë përmes ndarjes, rivendosjes së kufijve, integrimit me shtetet fqinje apo shfuqizimit të entiteteve, nuk janë në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së Dejtonit për Paqe, as me rrugën evropiane të Bosnje e Hercegovinës". "Udhëheqësit politikë duhet të përmbahen nga retorika përçarëse dhe provokuese dhe të respektojnë Kushtetutën e Bosnje e Hercegovinës. Diskursi publik, veçanërisht gjatë fushatave zgjedhore, duhet të përqendrohet në pritjet e qytetarëve në lidhje me përmirësimin e kushteve socio-ekonomike dhe mjedisore, si dhe reformat në fushat e sundimit të ligjit dhe demokracisë, të nevojshme për përparimin drejt anëtarësimit në BE", thekson BE-ja.
Zyra e Përfaqësuesit të Lartë (OHR) dhe OSBE-ja reaguan gjithashtu ndaj deklaratës së Stanivukoviqit.
ZPL-ja tha se "thirrjet e njëanshme për shfuqizimin e entiteteve, si dhe thirrjet për shkëputje, pavarësi ose bashkim me një shtet tjetër, janë në kundërshtim me kornizën



Midhat Poturovic (RFE/RL)

kushtetuese të Bosnje e Hercegovinës të përcaktuar nga Marrëveshja e Dejtonit për Paqe". Ajo deklaroi më 14 shtator se "qytetarët nuk duhet të mashtrohen nga premtime që nuk mund të përmbushen, as emocionet dhe frika e tyre nuk duhet të shfrytëzohen për përfitime politike". "Udhëheqësit politikë duhet të respektojnë Kushtetutën dhe duhet të përmbahen nga retorika nxitëse. Në vend të kësaj, ata duhet të përqendrohen në adresimin e nevojave reale të qytetarëve", thuhej në deklaratë.
Misioni i OSBE-së në Bosnjë tha se retorika politike që vë në pikëpyetje ekzistencën e shtetit të Bosnjës, ose të entiteteve të saj, është në kundërshtim me Marrëveshjen e Dejtonit për Paqe.
Dita e Unitetit, Lirisë dhe Flamurit Serb festohet si festë kombëtare që nga viti 2020, bazuar në një marrëveshje midis udhëheqjes së Serbisë dhe Republikës Sërpska, dhe shënohet në ditën kur Fronti i Selanikut u thye në vitin 1918 në Luftën e Parë Botërore.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# ÇLIRIMTARË, KOSOVA JU PRET

**Pas gati gjashtë vjetësh paraburgim në Hagë, sot (e mërkurë) populli i Kosovës pret me emocione të forta verdiktin për katër ish-krerët e UÇK-së. Qytetarët presin lirimin e plotë të të gjithë udhëheqësve të UÇK-së dhe kthimin e tyre në Kosovë. Shumica e komunave kanë organizuar hapësira publike ku qytetarët do të mund ta ndjekin drejtpërdrejt shpalljen e aktgjykimit, duke vendosur ekrane të mëdha në sheshe dhe ambiente të hapura. Ndërkaq, qytetarë të shumtë, përfaqësues të medieve, bashkëluftëtarë dhe bashkatdhetarë janë nisur drejt Hagës, për të qenë sa më pranë këtij momenti të rëndësishëm dhe historik për Kosovën**

EPOKA E RE Mal QORRAJ



PRISHTINË, 15 SHTATOR - Aktgjykimi ndaj ish-udhëheqësve të UÇK-së, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, do të shpallet sot (e mërkurë), më 16 shtator, në Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë, pas gati gjashtë vjetësh nga arrestimi dhe transferimi i tyre në paraburgim.

Trupi Gjykues ka caktuar orën 10:00 për shpalljen e aktgjykimit në çështjen gjyqësore "Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit".

Katër ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës u arrestuan në nëntor të vitit 2020 dhe që nga atëherë ndodhen në paraburgim në Hagë.

Gjykimi ndaj tyre nisi më 3 prill 2023, ndërsa procesi gjyqësor ka zgjatur më shumë se tri vjet. Ata akuzohen për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit të pretenduara se janë kryer gjatë viteve 1998-1999. Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi i kanë mohuar akuzat dhe janë deklaruar të pafajshëm.

Një ditë para shpalljes së këtij aktgjykimi, qytetarë, ish-deputetë të PDK-së, përfaqësues të medieve, bashkëluftëtarë dhe bashkatdhetarë janë nisur drejt Hagës, për të qenë sa më pranë këtij momenti të rëndësishëm dhe për ta përcjellë nga afër shpalljen e aktgjykimit. Ndërkohë, edhe në Kosovë janë bërë përgatitje për përcjelljen e seancës.

Shumica e komunave kanë organizuar hapësira publike ku qytetarët do të mund ta ndjekin drejtpërdrejt shpalljen e aktgjykimit, duke vendosur ekrane të mëdha në sheshe dhe ambiente të hapura.

Në prag të shpalljes së verdiktit final nga Dhomat e Specializuara në Hagë për Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Jakup Krasniqin dhe Rexhep Selimin, dje është mbajtur konferenca kombëtare "Lufta për UÇK-në", e organizuar nga platforma qytetare "Liria ka emër".

Ish-ministri i Jashtëm, Enver Hoxhaj, ka theksuar se lufta e popullit tonë për liri përfundoi më 12 qershor 1999, ndërsa lufta diplomatike u kurorëzua me shpalljen e pavarësisë më 2008. "Lufta e UÇK-së është e vetmja luftë çlirimtare e certifikuar nga NATO-ja. Dhe e vetmja drejtësi e pranuar është lirimi i plotë i të gjithë udhëheqësve të UÇK-së dhe kthimi i tyre në Kosovë!", ka thënë ai.

Në Kosovë, para katër ditësh, mijëra qytetarë marshuan në Prishtinë në kuadër të "Marshit për Liri", në mbështetje të Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit.

Marshimi u zhvillua nëpër sheshet kryesore të kryeqytetit, ndërsa një skenë për fjalime dhe performanca ishte vendosur në sheshin "Skënderbeu".

Me pjesëmarrje të madhe u mbushën edhe sheshi "Nëna Terezë" dhe "Zahir Pajaziti" si dhe rrugët që lidhen me këto hapësira.

Në mesin e pjesëmarrësve ishin përfaqësues të partive politike, veteranë të luftës, familjarë të të akuzuarve dhe familjarë të dëshmorëve të UÇK-së.

Kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Hysni Gucati, tha se veteranët dhe familjet e tyre kërkojnë një proces të drejtë dhe të paanshëm.

"Liria e Kosovës u fitua me mund e sakrificë. Asnjë sallë e gjyqit nuk mund ta fshijë këtë të vërtetë", tha Gucati.

Ndërkaq kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Bedri Hamza, tha se një vendim që do të konsiderohej i padrejtë nuk do të pranohej. "Prandaj atyre që marrin vendimet, nga ky shesh u themi: mendoni për pasojat para se të vendosni më 16 shtator", deklaroi Hamza.

Edhe kryetari i Aleancës, Ardian Gjini, tha se katër ish-krerët e UÇK-së kishin luftuar për lirinë e Kosovës dhe se, sipas tij, tani ka ardhur koha që atyre t'u shprehet mirënjohje. "Kush kurrë nuk do të arrijë ta ndotë tregimin tonë për liri", tha Gjini.

Shpallja e aktgjykimit do të jetë një nga momentet më të rëndësishme të këtij procesi gjyqësor, i cili ka mbajtur në qendër të vëmendjes zhvillimet në Hagë për gati gjashtë vjet, që nga arrestimi i ish-krerëve të UÇK-së në nëntor të vitit 2020.

Seanca e sotme do të jetë publike dhe do të transmetohet me 10 minuta vonesë në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe.

Pjesëmarrësit që kanë marrë ulëse në galerinë publike, në qendrën e medias apo në dhomat e informimit, janë njoftuar paraprakisht përmes postës elektronike.

Tashmë vëmendja është përqendruar te Haga, ku më 16 shtator, në orën 10:00, pritet të merret vendimi përfundimtar ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

## Gruda: PDK-ja pret lirimin e Thaçit, Veselit, Krasniqit dhe Selimit, do ta mbrojmë të vërtetën për luftën e UÇK-së

Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, Përparim Gruda, ka thënë se PDK pret lirimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit nga të gjitha aktakuzat, sepse lufta mbrojtëse dhe çlirimtare e Kosovës të nuk mund të vendoset në të njëjtin plan me politikën shtetërore të agresionit, represionit dhe spastrimit etnik të regjimit serb.

Gruda, në një konferencë për medie, 18 orë para shpalljes së verdiktit final nga Gjykata Speciale në Hagë, ka thënë se Kosova pret drejtësi. Gruda paralajmëroi se në rast se do të merret një vendim ndryshe, ai do të kundërshtohet me vendosmëri, me argumente dhe me të gjitha mjetet juridike e demokratike në dispozicion.

"Prandaj, edhe partnerëve tanë ndërkombëtarë u kërkojmë të njëjtën gjë që kemi kërkuar gjithmonë: drejtësi të bazuar në prova, standarde të barabarta dhe respekt për të vërtetën historike të Kosovës", tha deputeti i PDK-së.

Duke kujtuar represionin, dhunën, dëbimet, vrasjet dhe krimet e kryera ndaj popullit të Kosovës për dekada, Gruda tha se historia nuk mund të rishkruhet. Ai u bëri thirrje të gjithë aktorëve publikë ta ruajnë qetësinë dhe të mos krijojnë panik të panevojshëm te qytetarët.

## Self kritikon Hagën, shpreson që "paragjykimet politike" të mos ndikojnë në vendimin për çlirimtarët

PRISHTINË, 15 SHTATOR - Kongresmeni amerikan Keith Self ka reaguar lidhur me procesin gjyqësor ndaj katërshes së UÇK-së, duke shprehur shqetësimin se vendimet e institucioneve të drejtësisë mund të ndikohen nga, siç e quan ai, "paragjykimet politike". Në një postim të publikuar në rrjetet sociale, Self tha se një temë që, sipas tij, po bëhet gjithnjë e më e dukshme nga Haga është lejimi i ndikimit të politikës në vendimmarrje.

"Shpresa ime është që një paragjykim i tillë të mos jetë i dukshëm këtë javë, kur të merret një vendim në gjyqin e Hashim Thaçit dhe tre civilëve shqiptarë që luftuan për pavarësinë pas viteve të shtypjes serbe", shkroi Self. Ai e cilësoi rajonin e Ballkanit si një "fuçi baruti", duke paralajmëruar se regjimet shtypëse mund të kenë interes t'i nxisin ndarjet dhe tensionet në vend që të kontribuojnë në pajtim.

"Ballkani është një fuçi baruti në një rajon ku regjimet shtypëse nuk do të dëshironin asgjë më shumë sesa të ushqenin flakët e përçarjes, në vend që të punonin drejt pajtimit", thuhet në reagimin e tij.






# ZGJEDHJET DHE VONESAT INSTITUCIONALE NË KOSOVË ‘PENGOJNË AGJENDËN’’ ME SHBA-në

**Prishtinë, 15 shtator** - Shtetet e Bashkuara mbeten të përkushtuara ndaj pavarësisë dhe integritetit territorial të Kosovës, por paralajmërojnë se ngërçi i zgjatur politik po e pengon agjendën e përbashkët mes dy vendeve.
Ky pritet të jetë një nga mesazhet kryesore të zëvendësndihmëssekretarit amerikan të Shtetit, Daniel Lawton, gjatë dëshmisë së tij më 15 shtator para Nënkomisionit për Evropën të Komitetit për Punë të Jashtme të Dhomës së Përfaqësuesve të ShBA-së.
Në deklaratën e përgatitur për seancën dhe të bërë publike paraprakisht, Lawton përmend zgjedhjet e përsëritura në Kosovë, periudhën e gjatë me qeveri në detyrë dhe vonesat në formimin e institucioneve si faktorë që kanë penguar avancimin e prioriteteve të përbashkëta. “Kemi një agjendë të gjerë bashkëpunimi me Kosovën, e cila, fatkeqësisht, është penguar nga zgjedhjet e përsëritura, periudha e zgjatur me qeveri në detyrë dhe vonesat në formimin e institucioneve të nevojshme për avancimin e prioriteteve tona të përbashkëta”, thuhet në deklaratë.
Uashingtoni, sipas tij, u ka bërë thirrje udhëheqësve të Kosovës që ta përmbyllin procesin e formimit të institucioneve në përputhje me Kushtetutën dhe vendimet e gjykatave. Por, vërejtjet amerikane shkojnë edhe përtej ngërçit politik.
Lawton pritet të thotë se ShBA-ja ka ngritur shqetësime për atë që e përshkruan si “kontroll të tepruar ligjor dhe policor” ndaj popullsisë serbe të Kosovës. “Të gjithë qytetarët e Kosovës duhet të gëzojnë të drejta të barabarta dhe mbrojtje të barabartë nga ligji, nëse Kosova dëshiron ta ruajë stabilitetin”, thuhet në deklaratën e tij.
Lawton thekson, gjithashtu, rolin kritik të misionit të NATO-s, KFOR, në ruajtjen e një mjedisi të sigurt në Kosovë - mision në të cilin vazhdojnë të kontribuojnë edhe forcat amerikane.

## Dialogu Kosovë - Serbi ka ngecur

Normalizimin e marrëdhënieve dhe ruajtjen e paqes ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Lawton pritet t’i cilësojë si thelbësore për stabilitetin e Ballkanit Perëndimor. Sipas tij, që nga Marrëveshja e Uashingtonit e vitit 2020, e ndërmjetësuar nga presidenti amerikan, Donald Trump, gjatë mandatit të tij të parë, është bërë “përparim i rëndësishëm”. Megjithatë, ai vlerëson se dialogu i ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian ka ngecur, për shkak të “vullnetit të pamjaftueshëm politik nga të dyja palët”.
ShBA-ja, sipas deklaratës, vazhdon t’i bëjë thirrje Prishtinës dhe Beogradit që t’i shmangin provokimet, t’i përmbushin zotimet e tyre dhe t’u rikthehen bisedimeve të drejtpërdrejta pa parakushte.

## Partneriteti me Serbinë po forcohet

Për marrëdhëniet me Serbinë, Lawton pritet të thotë se Uashingtoni po punon që Shtetet e Bashkuara të jenë “partneri i zgjedhur”, me synimin për të kundërshtuar ndikimin e aktorëve kundërshtarë të ShBA-së. “Përpjekjet tona po funksionojnë dhe partneriteti ynë dypalësh po bëhet më i fortë”, thuhet në deklaratë.
Lawton përmend nisjen në korrik të Dialogut Strategjik ShBA - Serbi, i cili përfshin bashkëpunimin në energji, mbrojtje, siguri dhe ekonomi. Ai e cilëson Serbinë si një “vend kyç në ekuilibrin rajonal” dhe thotë se angazhimi me të do të mbetet i rëndësishëm për mbrojtjen e interesave amerikane.

## ShBA-ja kërkon “zgjidhje lokale për probleme lokale”

Në deklaratën e tij, Lawton paraqet edhe prioritetet më të gjera të politikës amerikane në Ballkanin Perëndimor. Ai thotë se ShBA-ja po u kërkon udhëheqësve të rajonit të mos vazhdojnë të rihapin mosmarrëveshjet e së kaluarës, por të përqendrohen në iniciativa konkrete për të çuar vendet e tyre përpara. “Ne mbetemi të gatshëm të punojmë me ata që janë të përgatitur të ecin drejt së ardhmes, por kemi pak interes për ata që do të minonin stabilitetin për qëllime vetjake, ose që vazhdojnë të rihapin mosmarrëveshje të dekadave të kaluara”, thuhet në deklaratën e Lawtonit.
Ai i referohet edhe qëndrimit të zëvendëssekretarit amerikan të Shtetit, Christopher Landau, se “epoka e ndërtimit të shteteve të imponuara nga jashtë ka përfunduar”. Kjo, sipas Lawtonit, nuk nënkupton tërheqjen amerikane nga Ballkani Perëndimor.
Ai thotë se ShBA-ja mbetet aktive në përpjekjet për rezultate që avancojnë interesat e saj dhe që u mundësojnë aktorëve lokalë t’i gjejnë vetë zgjidhjet.

## Tri shtyllat e politikës amerikane

Lawton e ndan politikën amerikane në Ballkanin Perëndimor në tri shtylla: stabiliteti, interesat ekonomike dhe tregtare dhe luftimi i kërcënimeve ndaj ShBA-së.
Stabiliteti, sipas tij, është parakusht për realizimin e të gjitha objektivave të tjera amerikane në rajon.
Në aspektin ekonomik, ShBA-ja synon të avancojë interesat e veta tregtare përmes rritjes së udhëhequr nga sektori privat dhe krijimit të një klime që favorizon investimet dhe bizneset amerikane.
Lawton i përshkruan stabilitetin dhe prosperitetin si objektiva që përforcojnë njëra-tjetrën.
Shtylla e tretë lidhet me kërcënimet ndaj sigurisë, përfshirë organizatat kriminale transnacionale nga Ballkani që bashkëpunojnë me kartelet në hemisferën perëndimore dhe që, sipas tij, përbëjnë kërcënim të drejtpërdrejtë për ShBA-në.
Uashingtoni pret gjithashtu që partnerët evropianë të marrin përsipër një pjesë më të madhe të barrës së sigurisë në rajon.
Nga aleatët e NATO-s në Ballkanin Perëndimor kërkohet modernizimi i ushtrive dhe përmbushja e zotimeve për shpenzimet e mbrojtjes.

## Bosnja, Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi

Për Bosnjë-Hercegovinën, Lawton rikonfirmon përkushtimin e ShBA-së ndaj sovranitetit dhe integritetit territorial të vendit dhe stabilitetit të siguruar nga

# MBI 50 MIJË EURO PËR NDIHMËSIT E DEPUTETËVE PËR KUVENDIN JOFUNKSIONAL



**PRISHTINË, 15 SHTATOR** - Megjithëse Kuvendi i Kosovës për më shumë se një muaj nuk zhvilloi punë parlamentare, gati gjysma e deputetëve angazhuan ndihmës personalë që në ditët e para pas betimit. Në këtë periudhë Kuvendi ishte i bllokuar në procesin e konstituimit dhe nuk mbajti seanca pune për shqyrtimin e ligjeve apo çështjeve të tjera të agjendës parlamentare. Njohës të punës së Kuvendit e vlerësojnë "të papërgjegjshëm dhe joetik" angazhimin e asistentëve në këtë periudhë.

Kuvendi u shpall i konstituuar vetëm më 13 shtator - madje, me një nënkryetar mangët, pasi Partia Demokratike e Kosovës (PDK) tërhoqi kandidaten e saj dhe nuk mori pjesë në vazhdimin e seancës inauguruese.

Më vonë, të njëjtën ditë, 62 deputetë zgjodhën Qeverinë e re të Kosovës, të katërtën e udhëhequr nga Albin Kurti i Lëvizjes Vetëvendosje (LV).

Nga gjithsej 120 deputetë sa ka Kuvendi, 52 prej tyre, deri më 11 shtator, kishin ushtruar të drejtën për të angazhuar asistentë. Madje, sipas të dhënave të siguruara nga organi legjislativ, 12 deputetë u bënë me ndihmës më 7 gusht, një ditë pas betimit të tyre.

Pjesa tjetër angazhuan asistentë ditëve të tjera të gushtit (32 deputetë) dhe gjatë shtatorit (8 ligjvënës).

### Sa do t'i kushtojnë buxhetit të Kosovës asistentët e deputetëve?

Rroga e një zyrtari personal, sipas Kuvendit, është 972.4 euro bruto, pa përfshirë shtesën për përvojën e punës.

Kësisoj, për një muaj, 52 asistentët do t'i kushtojnë buxhetit mbi 50 mijë e 500 euro.

Rregullorja e punës së Kuvendit përcakton se stafi politik i ofron mbështetje profesionale dhe teknike deputetit, në ushtrim të funksionit të tij.

Kurse me aktin e veçantë të miratuar nga Kryesia e Kuvendit, janë të rregulluar aspekte të tjera të angazhimit të kësaj kategorie të zyrtarëve politikë.

Sipas Rregullores për Shtesa mbi Pagën Bazë për Deputetët dhe asaj për Klasifikimin e Pagës për Stafin Mbështetës Politik të Kuvendit, kontrata e zyrtarëve të deputetëve është e lidhur me mandatin e punëdhënësit politik.

### Kush angazhoi asistentë?

Një ditë pas betimit më 6 gusht, asistentë angazhuan 12 deputetë: katër nga PDK-ja, shtatë nga Aleanca dhe një nga LV-ja.

Angazhimi i stafit mbështetës u intensifikua gjatë muajit gusht, kur u angazhuan edhe 32 asistentë, derisa në dhjetë ditët e para të shtatorit u morën në punë tetë asistentë të tjerë.

### "Sjellje e papërgjegjshme dhe joetike e deputetëve"

Sipas Naim Jakajt nga Instituti i Kosovës për Drejtësi dhe Eugen Cakollit nga Instituti Demokratik i Kosovës, fakti se angazhimi i asistentëve është i rregulluar në aspektin legjislativ nuk e justifikon veprimin nga deputetët – duke pasur parasysh se pa konstituimin e Kuvendit, ata nuk kishin obligime në të cilat do të mund t'iu ndihmonin asistentët.

Jakaj thotë për Radion Evropa e Lirë se deputetët që kanë angazhuar asistentë para konstituimit të Kuvendit, duhet ta arsyetojnë nevojën reale për angazhimin e tyre, si dhe punën konkrete që është kryer.

Pavarësisht se deputetët dhanë betimin, Kuvendi nuk ishte i konstituuar, kujton Jakaj, duke shtuar se ligjbërësit nuk kanë mundur ta ushtrojnë në plotësi funksionin e tyre parlamentar, ndërsa Kuvendi nuk ka zhvilluar aktivitetin e rregullt parlamentar që do ta arsyetonte në të njëjtën masë nevojën për staf mbështetës.

Jakaj thotë se problematike janë veçanërisht angazhimet e deputetëve menjëherë pas betimit, në një kohë kur nuk kishte punë parlamentare, komisione funksionale dhe seanca të rregullta. "Fakti që një veprim lejohet nga Rregullorja nuk e përfundon diskutimin. Legaliteti është vetëm standardi minimal. Nga deputetët kërkohet edhe përgjegjshmëri etike dhe profesionale në përdorimin e parasë publike", shprehet ai për REL-in.

Cakolli, ndërkaq, pohon se edhe vetë rregullorja e punës së Kuvendit angazhimin e asistentëve e lidh me ushtrimin e funksionit të deputetëve dhe, kësisoj, është e diskutueshme nëse ata mund të angazhonin staf mbështetës pa u konstituar Kuvendi. "Deputetët nuk mund të ushtrojnë funksion për sa kohë që nuk ka Kuvend të konstituuar, sepse i njëjti mund të fillojë punën, në bazë të përgjegjësive kushtetuese, pra ligjvënëse, mbikëqyrëse dhe përfaqësuese, vetëm pas konstituimit të plotë dhe formimit të grupeve punuese në Kuvend", thotë Cakolli për Radion Evropa e Lirë. Sipas tij, pagat e deputetëve dhe asistentëve të tyre zakonisht i kushtojnë taksapaguesve rreth 300 mijë euro në baza mujore.

"Problemi, në këtë rast, është se të drejtat financiare dhe benefitet që kanë deputetët po aktivizohen menjëherë, por përgjegjësitë edhe puna institucionale që ata kanë janë lënë në pritje, për të mos thënë janë zvarritur në tërësi", thotë Cakolli.

Ai vlerëson se është e domosdoshme që kjo çështje të rregullohet, duke përcaktuar se deputetët mund të angazhojnë staf mbështetës e të gëzojnë benefitet e tjera vetëm pas konstituimit të Kuvendit. "Në këtë mënyrë, evitohen rastet kur Kuvendi potencialisht mund të mos konstituohet me muaj të tërë, e jo vetëm që deputetët do të merrnin pagat e tyre, por do të merrnin paga edhe asistentët, të cilët, për fat të keq, besoj që kanë pasur nivel minimal, për të mos thënë inekzistent, të angazhimit", përfundon Cakolli.

## PDK-ja dorëzon në Kushtetuese lëndën e dytë, konteston zgjedhjen e qeverisë



**PRISHTINË, 15 SHTATOR** - Kryetari i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, Arian Tahiri, dhe deputeti Përparim Gruda kanë dorëzuar sot në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës lëndën e dytë me radhë për vlerësim kushtetues. Këtë herë PDK-ja ka kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë të vendimit nr. 11-V-007, të 13 shtatorit 2026, për zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Dorëzimi i kësaj kërkese vjen një ditë pasi PDK-ja dorëzoi në Kushtetuese lëndën që lidhet me procesin e konstituimit të Kuvendit.

PDK-ja kërkon që Gjykata Kushtetuese të vlerësojë nëse procedura dhe vendimi për zgjedhjen e qeverisë janë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, duke argumentuar se çdo institucion i ri duhet të ketë një bazë të pakontestueshme kushtetuese.

PDK-ja kërkon me ngulm rikthimin në rendin kushtetues, jo në një rend të imponuar nga Lëvizja Vetëvendosje, duke insistuar se institucionet e Republikës duhet të funksionojnë vetëm mbi bazën e Kushtetutës dhe jo të vullnetit politik të një partie.

Marrëveshja e Dejtonit. Ai pritet të thotë se diplomacia amerikane, vitin e kaluar, ndihmoi në zgjidhjen e një krize të gjatë, duke ruajtur kohezionin ligjor dhe rendin kushtetues të vendit dhe duke siguruar tërheqjen e legjislacionit të Republikës Sërpska që ishte në kundërshtim me Marrëveshjen e Dejtonit.

Lawton veçon edhe projektin e gazsjellësit të Interkoneksionit Jugor me Kroacinë, i cili, sipas tij, do të diversifikojë furnizimin me energji të Bosnje dhe Hercegovinës dhe do të krijojë mundësi për kompanitë amerikane.

Në Shqipëri, ShBA-ja po punon me autoritetet për luftimin e organizatave kriminale transnacionale dhe zgjerimin e qasjes së kompanive amerikane në treg.

Lawton përmend edhe një kredi të sapopërfunduar në kuadër të Financimit të Huaj Ushtarak, e cila, sipas tij, do ta ndihmojë Shqipërinë të përmbushë zotimet për shpenzimet e mbrojtjes në NATO dhe të rrisë blerjen e pajisjeve të prodhuara në ShBA.

Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi, Lawton i përshkruan si aleatë të afërt të NATO-s dhe partnerë të ShBA-së në fushën e sigurisë.

Për Maqedoninë e Veriut, ai veçon bashkëpunimin në mbrojtje, energji dhe infrastrukturë, si dhe Dialogun Strategjik ShBA-Maqedoni e Veriut të zhvilluar në prill.

Për Malin e Zi, Lawton përmend marrëveshjen ndërqeveritare të arritur së fundmi me ShBA-në, e cila krijon kornizë për bashkëpunim, përfshirë në Korridorin Adriatiko-Jonian.

Sipas Lawtonit, angazhimi amerikan në Ballkanin Perëndimor do të lidhet me objektiva të arritshme dhe rezultate të matshme, me fokus te zgjidhjet e drejtuara nga vetë vendet e rajonit, bashkëpunimi ekonomik dhe i sigurisë dhe avancimi i interesave amerikane.

# UÇK DO TË TRIUMFOJË EDHE MË 16 SHTATOR, KOSOVA NUK E DURON PADREJTËSINË!

Ata që gjatë viteve 1998-1999 e kanë penguar dhe sabotuar luftën e UÇK-së, e që sot e gjithë ditën bashkë me pasardhësit e tyre vazhdojnë ta sabotojnë produktin e UÇK-së - lirinë dhe shtetin e Kosovës, nuk mund ta ndryshojnë të vërtetën historike të rrugës sonë të lirisë. Ashtu siç kam qenë i bindur në vitet e luftës, jam i bindur edhe sot se Ushtria Çlirimtare e Kosovës do të triumfojë. UÇK do të triumfojë edhe më 16 shtator, duke triumfuar drejtësia dhe e vërteta e luftës sonë për liri. Duke besuar në vlerat e drejtësisë, kam bindjen që drejtuesit e luftës, Thaçi, Krasniqi, Veseli e Selimi do ta fitojnë pafajësinë dhe do t'u kthehen familjeve të tyre dhe atdheut për lirinë e të cilit luftuan. Kosova po pret drejtësi, po pret fitore të drejtësisë! Prandaj, edhe këtaj radhe lufta e drejtë e UÇK-së do të triumfojë! Kosova nuk do ta pranojë e as nuk do ta durojë asnjëherë padrejtësinë. Këtë e ka dëshmuar çdoherë në kohë vendimtare!



Shkruan: Arianit BYTYÇI

Hashim Thaçi, Rexhep Selimi dhe Kadri Veseli kur e nisën angazhimin e tyre për ta themeluar Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës ishin studentë të Universitetit të Prishtinës, që asokohe pas mbylljes së UP-së nga Serbia mbanin ligjëratat jashtë ndërtesave universitare, pra në shtëpitë private që qytetarët shqiptarë kishin lëshuar për mbijetesën e Universitetit. Ndërsa, Jakup Krasniqi ishte në vitet e para të daljes nga burgu politik i Serbisë dhe kthimit në burgun e madh të Kosovës, siç do të theksonte simboli i rezistencës sonë kombëtare Adem Demaçi pas daljes nga burgu.

Vetëm ky rikthim në kohë, në fillim të nëntëdhjetave, dëshmon më së miri rrethanat, kontekstin kohor të mungesës së lirisë dhe mbi të gjitha qëllimin fisnik e guximin kombëtar për të luftuar për liri. Thaçi, Selimi, Veseli e Krasniqi ishin idealistë, pasi Kosova më shumë se asnjëherë pikërisht në atë kohë kishte nevojë për njerëz të këtij kalibri. Dhe vetëm disa vite më vonë, pikërisht këto figura natyrshëm do të merrnin përgjegjësinë ta udhëhiqnin Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës në luftën e saj për çlirimin e Kosovës dhe ndërtimin e shtetit demokratik të Kosovës. Dhe qëllimi u arrit: Kosova u çlirua me 12 qershor 1999 dhe u pavarësua me 17 shkurt 2008.

Më kujtohet si sot kur në një nga ditët e para të qershorit 1998 u lajmërova në telefonin e banesës. Ishte një zë burri që fliste me qetësi e mirësjellje. U prezantua me emrin, me nofkën Studenti dhe kërkonte babanë tim, gazetarin Nuhi Bytyçi. Në vazhdim, po bisedonte me babanë tim, të cilin e kishte takuar vetëm disa ditë më parë në malet e Kosovës dhe po i thoshte se mund të vish në 2 ditët e ardhshme për ta xhiruar paraqitjen e parë publike të zëdhënësit të UÇK-së. Ky burrë më vonë nga babai mora vesh se ishte Hashim Thaçi. Dhe këtë e mora vesh vetëm kur ai u shpall drejtues politik i UÇK-së, jo më herët. Para se të emërohej drejtues politik i UÇK-së, Hashim Thaçi drejtonte informimin dhe komunikimin publik të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së dhe në këto kapacitete ndihmonte babin që në krijimin e mundësive për të realizuar emisione nga zonat e luftës në mbështetje të UÇK-së. Kush do të besonte se vetëm 2 vite më vonë, që nga janari i vitit 2000 dhe në vitet në vazhdim do të bashkëpunoja me Thaçin e UÇK-së e do ta mbështesja pikërisht në fushën e komunikimit me publikun atë dhe subjektin e tij politik dhe më vonë edhe qeverinë që ai udhëhiqte gjatë procesit të shtetndërtimit të Kosovës.

Jakup Krasniqin e Rexhep Selimin i mbaj mend nga pritja e Vitit të Ri 1999 në kohë lufte bashkë me bashkëluftëtarët e tyre në Fshat të Ri, Lladroc, Javur, Banjë e Guriq. Rexha si një luftëtar i ri, që shuhej me oratorinë e tij dhe me formimin e tij letrar e artistik, me Pentiumin e tij kishte arritur që në kushte lufte të dizajninte kalendarin e Vitit të Ri 1999, që do të ishte viti i çlirimit të Kosovës. Kalendarin e kishte vendosur në murin e shtëpisë ku vepronte një pjesë e ShP të UÇK-së në Fshat të Ri.

Për Kadri Veselin - Lulin, babai im Nuhiu më kishte folur fjalët më të zgjedhura. Më kishte folur për afërsinë e tij, për çiltërsinë e tij si luftëtar, i cili bashkë me Hashim Thaçim, Rexhep Selimin, Jakup Krasniqin, Fatnir Limajn, Ferat Shalën, Ramë Bujën, Bislim Zyrapin, Shaban Shalën, Sulejman Selimin, Agim Çelajn, Ismet Jasharin, Fehmi Lladrovcin, Rrustem Mustafën, Lahi Brahimajn, Shukri Bujen, Rrahmen Ramën, Kadri Kastratin, Tahir Sinanin, Sami Lushtakun, Ramush Haradinajn, Sokol Bashotën, Nuri Bexhetin, Haxhi Shalën e shumë drejtues tjerë të UÇK-së, e mbështesnin punën e madhe të ekipit televiziv të Programit Satelitor të Kosovës në kuadër të Televizionit Shqiptar, në zonat e luftës, që e udhëhiqte babi dhe axha Abaz.

Sot është anakronike dhe jashtë çdo logjike racionale ligjore dhe politike, që mbi 30 vite nga fillimi i angazhimeve për ta themeluar dhe organizuar UÇK-në për ta çliruar Kosovën, pikërisht drejtuesit kryesorë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Thaçi e Krasniqi të Politikës së luftës, Selimi i Operativës dhe Veseli i Inteligjencës së luftës, gjenden prapa grilave në një proces të stisur nga Raporti skandaloz e i pabazuar i Dick Martyt për kinse trafikim organesh nga UÇK-ja, që u hodh poshtë nga vetë ata që hetuan me vite të tëra këto pretendime monstruoze.

Shumë vite pas shfaqjes së Marty-t me raportin e tij famëkeq, në një kohë të tentimit të ekuilibrave të SHBA-ve me Rusinë, partnerët tanë ranë në grackën ruse dhe bënë presion të padrejtë mbi institucionet e Kosovës që të themelojnë Dhomat e Specializuara të Kosovës me seli në Hagë, të cilat do të trajtonin pretendimet e Raportit të Maryt. Asokohe si drejtor i Zyrës për Komunikim me Publikun të kryeministrit Thaçi isha dëshmitar i guximit, i gatishmërisë dhe lidershipit të z. Thaçi për t'u përballur në mënyrë të hapur me pretendimet e pabazuara dhe qëllimkëqija të Dick Martyt. Qeveria e Kosovës ofroi mbështetjen e gjithanshme dhe bashkëpunimin institucional për hetimin e këtyre pretendimeve.

Në fund, pas shumë vitesh hetime jo vetëm në Kosovë por edhe në Shqipëri e gjetiu, Dhomat e Specializuara të Kosovës me seli në Hagë, të themeluara nga Kuvendi i Kosovës pas një presioni të paprecedent ndërkombëtar pikërisht mbi drejtuesit e Qeverisë e të Kuvendit të Kosovës, që kishin qenë edhe drejtues të UÇK-së, e që ishim vënë padrejtësisht në shënjestër të Rusisë e Serbisë përmes Gjykatës Speciale, edhe me aprovimin e heshtur të partnerëve tanë ndërkombëtarë të cilët synonin ekuilibra politik me Rusinë, akuzuan drejtuesit kryesorë të luftës sonë çlirimtare. Çmimi për Kosovën ishte i lartë, jashtëzakonisht i lartë: në procesin e avancimit e të konsolidimit të shtetit të Kosovës, po nxirrej nga zyra presidenti i vendit, drejtuesi politik i luftës për liri, kryesuesi i delegacionit shqiptar të Kosovës në bisedimet e Rambujesë dhe Parisit, ish-kryeministri Hashim Thaçi. Po burgosej ish-kryetari i Kuvendit, kuvendit që kishte shpallur Pavarësinë e Kosovës, zëdhënësi i UÇK-së, bashkëdrejtuesi i grupit politik të delegacionit shqiptar të Kosovës në Rambuje e Paris, Jakup Krasniqi. Po burgoseshin ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, drejtuesi i Inteligjencës së UÇK-së, kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli dhe shefi i grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, drejtuesi i Operativës së UÇK-së, njeriu që kishte dalë për herë të parë për t'iu drejtuar popullit të Kosovës në emër të UÇK-së, Rexhep Selimi. Dhe, ata për 6 vite do të përballeshin jo me akuzat e Raportit të Dick Martyt, por me një aktakuzë skandaloze, të pabazuar e të paqëndrueshme, pretendimet e së cilës kishin qenë objekt trajtimi i gjykatave ndërkombëtare e vendore në Kosovë, që nga gjykatat e UNMIK-ut dhe EULEX-it e deri te Tribunali i Hagës.

Gjatë tërë procesit të stërzgjatur gjyqësor, është dëshmuar katërcipërisht se një organizim vullnetar, një ushtri vullnetare. siç ishte Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk kishte qëllime e objektiva kriminale. U dëshmua që UÇK-ja nuk ishte ndërmarrje e përbashkët kriminale, siç pretendon prokuroria, por UÇK-ja ishte ndërmarrje e përbashkët çlirimtare, siç e tha njëzëri populli i Kosovës me marshin e 12 shtatorit dhe në të gjitha marshet e protestat tjera që nga koha e luftës, ku në mes të Prishtinës jehonte emri i UÇK-së i thirrur me zemër nga rinia prishtinase, e deri te protestat gjithëpopullore të pasluftës, ku në vazhdimësi kërkohet drejtësi për çlirimtarët.

Prandaj, me bindje e besim në drejtësi, natyrshëm pres që vendimi i Trupit Gjykues me 16 shtator 2026 do të jetë në shërbim të konfirmimit të së vërtetës historike se Ushtria Çlirimtare e Kosovës, një ushtri që doli nga gjiri i popullit, që u themelua nga studentë të Universitetit të Prishtinës, si Hashimi, Rexha, Kadriu, Fatmiri, Remi e shumë bashkëluftëtarë të tjerë, nga të burgosurit politikë, nga idealistët si Jakup Krasniqi, Ilmi Ramadani, Azem Syla e shumë veprimtarë tjerë, që luftonin për liri e dinjitet, është organizimi më i suksesshëm çlirimtar i Kosovës.

Këtë realitet historik të UÇK-së e kam përjetuar në lëkurën time si nxënës i gjimnazit në vitet 1998-1999, atëherë kur angazhimi për ta mbështetur hapur UÇK-në dhe luftën e saj për liri në qendër të Prishtinës, përveçse guxim e qëllim fisnik ishte krenari e dinjitet. Ata që gjatë asaj kohe e kanë penguar dhe sabotuar luftën e UÇK-së, e që sot e gjithë ditën bashkë me pasardhësit e tyre vazhdojnë ta sabotojnë produktin e UÇK-së - lirinë e Kosovës, nuk mund ta ndryshojnë të vërtetën historike të rrugës sonë të lirisë. Ashtu siç kam qenë i bindur në vitet e luftës, 1998 dhe 1999, jam i bindur edhe sot se Ushtria Çlirimtare e Kosovës do të triumfojë. UÇK do të triumfojë edhe më 16 shtator, duke triumfuar drejtësia dhe e vërteta e luftës sonë për liri. Duke besuar në vlerat e drejtësisë, kam bindjen që drejtuesit e luftës, Thaçi, Krasniqi, Veseli e Selimi do të fitojnë pafajësinë dhe do t'iu kthehen familjeve të tyre dhe atdheut për lirinë e të cilit luftuan. Kosova po pret drejtësi, po pret fitore të drejtësisë! Prandaj, edhe këtaj radhe lufta e drejtë e UÇK-së do të triumfojë! Kosova nuk do ta pranojë e as nuk do ta durojë asnjëherë padrejtësinë. Këtë e ka dëshmuar çdoherë në kohë vendimtare!

# VDIQ FLORA BROVINA, LA GJURMË TË PASHLYESHME NË HISTORINË E KOSOVËS DHE TË SHQIPTARËVE



PRISHTINË, 15 SHTATOR - Është ndarë nga jeta ish-deputetja e Kuvendit të Kosovës, Flora Brovina, në moshën 76-vjeçare. Lajmin e ka dhënë familja e saj përmes një njoftimi të publikuar në "Facebook" nga Ylli Begu. "Me pikëllim të thellë në zemër njoftojmë familjarët, miqtë, bashkëpunëtorët dhe të gjithë ata që e njohën dhe e deshën, se u nda nga jeta më e dashura jonë, dr. Flora Brovina", thuhet në njoftimin e familjes.

Brovina ishte e burgosur politike, veterane e luftës së UÇK-së, deputete dhe nënshkruese të Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës. "Flora jetoi një jetë të mbushur me dashuri për familjen, për njeriun dhe për atdheun. Si mjeke u shërbeu njerëzve me përkushtim e dhembshuri; si poete na la fjalën dhe shpirtin e saj; ndërsa me veprën, qëndresën dhe humanizmin e saj la gjurmë të pashlyeshme në historinë e Kosovës dhe të shqiptarisë", thuhet më tej në njoftim.

Flora Brovina lindi në vitin 1949 në Skenderaj dhe u rrit në Prishtinë, ku kreu shkollimin fillor dhe më pas studioi mjekësinë.

Pas përfundimit të specializimit në Zagreb, ajo u kthye në Kosovë. Për një periudhë punoi gazetare në gazetën "Rilindja", ndërsa më pas iu rikthye profesionit të mjekes.

Brovina punoi për shumë vjet në Repartin e Pediatrisë në Spitalin e Përgjithshëm të Prishtinës, ndërsa krahas profesionit të saj u angazhua edhe në letërsi dhe në mbrojtjen e të drejtave të grave.

Në skenën politike ajo shërbeu si deputete e Kuvendit të Kosovës nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës për gjashtë mandate nga viti 2001 deri më 2019.

Familja, në njoftimin për vdekjen e saj, ka theksuar se përtej kontributit publik, Brovina ishte një figurë e rëndësishme e familjes. "Për ne, përtej veprës dhe kontributit të saj publik, ajo ishte nëna dhe gjyshja jonë e dashur, motra dhe zemra e familjes sonë", thuhet në njoftim.

Familja Begu & Brovina kanë bërë me dije hollësitë për ceremoninë e varrimit dhe pritjen për ngushëllime do të njoftohen me kohë. "Do ta kujtojmë me mall, dashuri dhe mirënjohje të përjetshme. U prehtë në paqe", thuhet në fund të njoftimit.

# BEKIM SEJDIU TËRHIQET NGA KANDIDATURA PËR PRESIDENT




PRISHTINË, 15 SHTATOR - Bekim Sejdiu ka njoftuar se është tërhequr nga kandidatura për president të Kosovës për shkak të, siç ka thënë, mungesës së nevojshme të deputetëve për zgjedhjen e tij.

Ky njoftim i Sejdiut është cilësuar nga zyrtarë të Lëvizjes Vetëvendosje dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës si "humbje" për vendin dhe duke argumentuar se mosarritja e konsensusit për çështjen e presidentit po rrezikon që vendi të përballet me zgjedhje të reja.

Sejdiu, ish-gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese dhe ish-diplomat, tha se për këtë vendim e ka njoftuar Lëvizjen Vetëvendosje dhe Lidhjen Demokratike të Kosovës, parti që e propozuan si kandidat të përbashkët për president. "Në rrethanat e krijuara, të karakterizuara nga mungesa e mbështetjes së nevojshme parlamentare për zgjedhjen time si presidentit dhe nga devijimi i tërë procesit në vorbullën e dinamikave dhe përplasjeve të brendshme politike, kam vendosur të tërhiqem nga kandidatura për president të Republikës së Kosovës", shkroi ai në "Facebook".

Më 31 gusht LV-ja dhe LDK-ja njoftuan se ishin pajtuar që Sejdiu ishte kandidat i përbashkët për president, pas një sërë raundesh të negociatave.

Por, një ditë më vonë gjashtë deputetë të LDK-së thanë se nuk e mbështesin Sejdiun.

Sejdiu tha se kishte shprehur që deputetët dhe partitë politike do t'i tejkalonin ndasitë për t'i dhënë vendit stabilitet institucional. Sipas tij, Kosova dhe qytetarët e saj "nuk kanë nevojë për drama politike dhe thellim të polarizimit, por për maturi dhe bashkim në funksion të forcimit të shtetit tonë".

"Prandaj, me sinqeritetin më të madh shpresoj se partitë politike do të gjejnë rrugëdalje nga ky rreth vicioz, i cili, më shumë se çdo gjë tjetër, po e venitë shpresën e qytetarëve për një të ardhme prosperuese për ta dhe familjet e tyre", shkroi ai në "Facebook".

Pas njoftimit të Sejdiut, kreu i LDK-së, Lumir Abdixhiku, tha se me tërheqjen nga kandidatura, Sejdiu tregoi "dinjitet". Ai e falënderoi Sejdiun për gatishmërinë e treguar për të kandiduar, por tha se në vend të zgjidhjes politike për çështjen e presidentit, "zgjedhjet e reja" janë vendosur si qëllim.

Shefja e grupit parlamentar e Lëvizjes Vetëvendosje, Arbërie Nagavci, tha se tërheqja e Sejdiut është "humbje" për një proces që, sipas saj, do të duhej të sillte në vëmendje personalitete me integritet, profesionalizëm dhe kredibilitet.

Për zgjedhjen e presidentit të Kosovës duhet të jetë prania e të paktën 80 deputetëve në sallën e Kuvendit, i cili ka gjithsej 120 vende.

Kurti një ditë më parë u bëri thirrje deputetëve të partive opozitare për bashkëpunim në zgjedhjen e presidentit të ri.

Kuvendi i Kosovës u konstituua të dielën pa zgjedhjen e nënkryetarit të dytë, i cili i takon PDK-së, pasi kjo e fundit nuk mori pjesë në seancë duke e akuzuar pushtetin për shkelje të procesit.

Ndërkaq, disa orë më vonë u zgjodh edhe qeveria. Në seancë nuk morën pjesë PDK-ja, LDK-ja dhe Aleanca.

Kosova po përballet me jostabilitet politik, pasi vendi ka mbajtur tri palë zgjedhje parlamentare që nga shkurti i vitit 2025.

Nëse deputetët nuk arrijnë të zgjedhin kreun e ri të shtetit, qytetarët do t'u drejtoheshin kutive të votimit për të dytën herë për shkak të moskonsensusit për zgjedhjen e presidentit të ri të vendit.

## Rama uron Kurtin për mandatin e ri qeverisës, e fton për vizitë në Shqipëri

PRISHTINË, 15 SHTATOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, pranoi letër urimi për mandatin e ri qeverisës nga kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama. "Mandati juaj i ri qeverisës më ofron rastin e duhur t'ju përcjell urimet e mia më të përzemërta për sukses. Gjithashtu, e shfrytëzoj këtë mundësi për të riafirmuar gatishmërinë time dhe të Qeverisë që unë drejtoj, për një bashkëpunim të gjithanshëm, në të gjitha nivelet dhe në të gjitha fushat, për të përshpejtuar hapat në rrugëtimin tonë sfidues drejtë Shtëpisë së Përbashkët Evropiane. Zbatimi sa më i plotë i marrëveshjeve të miratuara dhe shqyrtimi e angazhimi në projekte të reja, nga sektorët më të rëndësishëm e prioritarë, janë në dobi dhe do të përmirësojnë e pasurojnë më tej jetën e qytetarëve tanë", shkroi kryeministri Rama.

Duke uruar përparim të gjithanshëm të Republikës së Kosovës, kryeministri Rama e ftoi kryeministrin Kurti për vizitë në Republikën e Shqipërisë.



# AKB-ja NË FORUMIN EKONOMIK TË OBT-së, AGIM SHAHINI THEKSOI RËNDËSINË QË KOSOVA TË JETË MË AKTIVE NË EKONOMINË GLOBALE

**Prishtinë, 15 shtator** - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) po merr pjesë në Forumin Ekonomik të Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT) "Powering the Future", një nga forumet e rëndësishme ndërkombëtare ku diskutohen e ardhmja e tregtisë globale, zhvillimi ekonomik, investimet dhe sfidat e ekonomisë botërore.

Në kuadër të këtij forumi, Agim Shahini, kryetar i Aleancës Kosovare të Bizneseve - AKB, zhvilloi një takim me drejtoreshën e përgjithshme të Organizatës Botërore të Tregtisë, Ngozi Okonjo-Iweala, duke e vendosur Kosovën dhe interesat e komunitetit të biznesit të Kosovës në vëmendjen e dialogut ekonomik ndërkombëtar.

Gjatë takimit u diskutuan mundësitë për rritjen e bashkëpunimit ekonomik, zgjerimin e tregjeve për bizneset e Kosovës, rritjen e eksporteve dhe përfshirjen më të madhe të sektorit privat të Kosovës në tregtinë ndërkombëtare.

Agim Shahini theksoi rëndësinë që Kosova të jetë më aktive në ekonominë globale dhe që bizneset e Kosovës të kenë mundësi të reja për të depërtuar në tregjet ndërkombëtare.



"Kosova nuk duhet të jetë vetëm një treg që importon, por duhet të bëhet një ekonomi që prodhon, eksporton dhe konkurron në tregun global. Prania e AKB-së në OBT është një mundësi për ta çuar zërin e biznesit kosovar aty ku diskutohen drejtimet e ardhshme të ekonomisë botërore", u shpreh Shahini.

AKB ndër vite ka marrë pjesë në aktivitete dhe forume ndërkombëtare të kësaj natyre, duke përfaqësuar interesat e komunitetit të biznesit kosovar, duke promovuar potencialet ekonomike të Kosovës dhe duke kërkuar mundësi të reja për investime, eksporte, partneritete dhe bashkëpunim ndërkombëtar.

Pjesëmarrja në Forumin Ekonomik të OBT-së "Powering the Future" është një tjetër dëshmi se biznesi kosovar duhet të jetë pjesë e tryezave ku vendoset dhe diskutohet e ardhmja e tregtisë globale.

AKB do të vazhdojë të punojë për ndërkombëtarizimin e sektorit privat, promovimin e produkteve "Made in Kosovo", rritjen e eksporteve dhe krijimin e lidhjeve të reja me komunitetet e biznesit dhe institucionet ekonomike ndërkombëtare.

# STRATEGIC GROUP DHE HRH PRINCI NAIF AL SAUD HAPIN NJË EPOKË TË RE: MBI 10 MILIARDË DOLLARË INVESTIME PËR KOSOVËN DHE SHQIPËRINË

**Prishtinë, 15 shtator** - Strategic Group ka nënshkruar një marrëveshje strategjike historike me Lartmadhërinë e Tij Mbretërore, Princin Naif bin Abdullah bin Saud bin Abdulaziz Al Saud, duke hapur një platformë të re madhore investimesh që synon të sjellë mbi 10 miliardë dollarë amerikanë investime të huaja në Kosovë dhe Shqipëri. Kjo marrëveshje përfaqëson një hap të rëndësishëm në misionin e Strategic Group për të pozicionuar të dy vendet si destinacione të fuqishme për kapital ndërkombëtar, partneritete strategjike dhe zhvillim ekonomik afatgjatë.

Në kuadër të marrëveshjes, kompanitë e fuqishme dhe interesat kryesore të biznesit të HRH Princit Naif bëhen pjesë e rrjetit të Strategic Group, duke krijuar një platformë të përbashkët për identifikimin, zhvillimin dhe realizimin e projekteve të mëdha investuese në Kosovë dhe Shqipëri.

Bashkëpunimi do të fokusohet në sektorë me rëndësi strategjike, përfshirë energjinë, infrastrukturën, turizmin, pasuritë e paluajtshme, shëndetësinë, prodhimin, teknologjinë dhe industri të tjera me potencial të lartë zhvillimi.

Në zemër të kësaj marrëveshjeje qëndron një objektiv i qartë: ringjallja ekonomike dhe krijimi i vendeve të punës.

Strategic Group do t'u japë përparësi investimeve që krijojnë punësim të qëndrueshëm, fuqizojnë bizneset vendore, zgjerojnë kapacitetet prodhuese dhe krijojnë mundësi të reja për të rinjtë dhe komunitetet në të dy vendet. Përmes ndërthurjes së kapitalit ndërkombëtar, ekspertizës rajonale dhe bashkëpunimit institucional, kjo nismë synon që investimet e mëdha të përkthehen në rritje konkrete ekonomike dhe prosperitet afatgjatë.

Strategic Group shpreh falënderimin dhe mirënjohjen e veçantë ndaj Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për mbështetjen, bashkëpunimin dhe gatishmërinë e treguar. Strategic Group do të punojë ngushtë me të dy qeveritë për t'i harmonizuar projektet dhe



objektivat investuese me prioritetet kombëtare të zhvillimit ekonomik, krijimit të vendeve të punës dhe forcimit të konkurrueshmërisë.

Përmes këtij partneriteti të ri me HRH Princin Naif, Strategic Group synon të hapë një kapitull të ri investimesh, zhvillimi dhe rritjeje për Kosovën dhe Shqipërinë, duke forcuar rolin e tyre si qendra ekonomike gjithnjë e më të rëndësishme në Evropën Juglindore.

# KOLEGJIUMI I ZYRTARËVE LIGJORË DISKUTOI PROJEKT-UDHËZIMET QË NDËRLIDHEN ME KOMPETENCAT, PËRGJEGJËSITË DHE OBLIGIMET E KOMUNAVE

**Prishtinë, 15 shtator** - Asociacioni i Komunave të Kosovës, me mbështetjen e OSBE-së, mbajti takim me Kolegjiumin e Zyrtarëve Ligjorë, ku temë e diskutimit ishin Projekt-Udhëzimet Administrative për banim social dhe të përballueshëm.

Gjatë takimit u diskutuan në mënyrë të veçantë dispozitat e këtyre Projekt-Udhëzimeve që ndërlidhen me kompetencat,



përgjegjësitë dhe obligimet e komunave, me qëllim të identifikimit të çështjeve që mund të paraqesin vështirësi në zbatimin e tyre në nivelin lokal.

Fokusi i diskutimit ishte në nenet përkatëse të Projekt-Udhëzimeve Administrative, të cilat përcaktojnë detyrimet e komunave në fushën e banimit social dhe të përballueshëm.

Në këtë kuadër u shqyrtua roli i komunave në planifikimin, organizimin dhe zbatimin e politikave dhe masave për sigurimin e banimit social dhe të përballueshëm si dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga dispozitat e propozuara.

Vëmendje e veçantë iu kushtua çështjes së kapaciteteve institucionale dhe financiare të komunave për përmbushjen e obligimeve të përcaktuara me këto akte.

Në përfundim u vlerësua se diskutimi i Projekt-Udhëzimeve Administrative për banim social dhe të përballueshëm është i rëndësishëm për komunat, veçanërisht për shkak të obligimeve që parashihen për nivelin lokal.

Asociacioni i Komunave të Kosovës do të vazhdojë të përcjellë dhe të adresojë çështjet që ndërlidhen me kompetencat dhe obligimet e komunave, duke synuar që në versionin përfundimtar të Projekt-Udhëzimeve të sigurohet një përcaktim i qartë i përgjegjësive dhe kushteve të nevojshme për zbatimin e tyre.

## Prishtina merr Presidencën e Rrjetit të Qyteteve të Ballkanit B40 për vitin 2027

**Prishtinë, 15 shtator** - Prishtina do ta marrë Presidencën e Rrjetit të Qyteteve të Ballkanit B40 për vitin 2027, ndërsa Samiti B40 pritet të mbahet në kryeqytetin e Kosovës në janar të vitit të ardhshëm.

Lajmin e ka bërë me dije kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, i cili ka njoftuar se qyteti është ftuar zyrtarisht nga kryetari i Zagrebit dhe presidenti aktual i B40, Tomislav Tomašević, për ta marrë drejtimin e rrjetit gjatë vitit 2027.

Sipas Ramës, marrja e Presidencës përbën një vlerësim për rolin e Prishtinës në rajon, por edhe një mundësi për ta shndërruar kryeqytetin në një platformë të dialogut, bashkëpunimit dhe zhvillimit ndërmjet qyteteve të Ballkanit.

Mbështetje për Prishtinën për marrjen e Presidencës ka shprehur edhe Sarajeva. Në letrën zyrtare, sipas Ramës, Sarajeva ka vlerësuar lidershipin e Prishtinës dhe orientimin e saj drejt gjithëpërfshirjes, partneritetit dhe vizionit evropian. "Në 2027-n Prishtina nuk do të jetë vetëm pjesë e tavolinës së qyteteve të Ballkanit, do ta udhëheqë atë", ka shkruar Rama. Ai e ka përmbyllur postimin me mesazhin: "Prishtina po rritet. Po lidhet. Po udhëheq".



# KUFIRI I ARDHSHËM NUK ËSHTË INTELIGJENCA ARTIFICIALE, POR SHOQËRITË ARTIFICIALE



Ekziston një prirje për ta ndarë të ardhmen e inteligjencës artificiale mes dy mundësive: utopisë ose katastrofës. Asnjëri prej këtyre dy skajeve nuk është veçanërisht i dobishëm. Duhet të mendojmë edhe për shoqëritë artificiale

Mundësia më interesante është më e ndërlikuar dhe kërkon një ndryshim rrënjësor në mënyrën tonë të të menduarit: të kalojmë nga inteligjenca artificiale te shoqëritë e inteligjencës artificiale.

Kur shumica e njerëzve dëgjojnë termin «IA», zakonisht mendojnë për ChatGPT-në, Copilot-in apo një sistem tjetër bashkëbisedues. Ti bën një pyetje dhe sistemi gjeneron një përgjigje.

Por IA-ja po ecën me shpejtësi përtej kësaj. Sistemet tashmë mund ta monitorojnë botën, të marrin vendime, të negociojnë transaksione dhe të kryejnë detyra përgjatë periudhave të gjata kohore. IA-ja nuk po gjeneron më thjesht një përgjigje, ajo po bën diçka konkrete në lidhje me të.

Kjo na çon drejt diçkaje shumë më të madhe sesa një chatbot më i mirë: drejt një bote në të cilën agjentët e IA-së veprojnë në emrin tonë dhe, gjithnjë e më shumë, ndërveprojnë me agjentë të tjerë të IA-së.

Një agjent percepton atë që po ndodh, vendos se çfarë duhet të bëjë dhe më pas ndërmerr veprime për ta arritur këtë qëllim. Ai mund të rezervojë një udhëtim, të monitorojë një zinxhir furnizimi, të koordinojë një ekip ose të menaxhojë financat e një familjeje.

Tani imagjinoni jo një agjent të vetëm, por miliona të tillë. Agjenti juaj i IA-së mund të negociojë një kredi hipotekare me agjentin e bankës suaj, të caktojë një ndërhyrje kirurgjikale me agjentin e një spitali dhe të riorganizojë planet tuaja të udhëtimit, duke komunikuar drejtpërdrejt me agjentët e kompanive ajrore, hoteleve dhe shoqërive të sigurimeve.

Kjo e ardhme është shumë më pranë nga sa duket dhe duhet t'i ndryshojë pyetjet që po bëjmë për inteligjencën artificiale. Deri tani, prirja ka qenë të përqendrohemi te niveli i inteligjencës që mund të arrijë një agjent i vetëm. Sfida më e thellë është ajo që ndodh kur miliona agjentë ndërveprojnë me njëri-tjetrin në shkallë të gjerë.

## Ngritje për shoqëritë artificiale

Themelet intelektuale të sistemeve të sotme të IA-së u hodhën shumë kohë përpara ChatGPT-së.

Për dekada me radhë, unë dhe studiues të tjerë të rrjeteve me shumë agjentë kemi studiuar se si agjentët autonomë mund të bashkëpunojnë, të bashkërendohen dhe të negociojnë kur askush nuk zotëron informacion të plotë dhe askush nuk kontrollon gjithçka.

Sistemet e para që u krijuan u përqendruan te mënyra se si fushat e veçanta të IA-së, arsyetimi, planifikimi dhe veprimi, mund të ndërthureshin për të krijuar një agjent të efektshëm dhe të orientuar drejt një qëllimi, si edhe te mënyra se si dhjetëra agjentë të tillë mund të komunikonin dhe të bashkëpunonin për të përmbushur një objektiv të përbashkët.

Teksa këto ndërveprime u bënë më të ndërlikuara dhe përfshinë më shumë agjentë, ndodhi një kalim nga bashkëpunimi mes agjentëve që i përkisnin të gjithë së njëjtës organizatë, drejt agjentëve me pronarë të ndryshëm dhe, ndonjëherë, me synime konkurruese. Kjo e zhvendosi vëmendjen drejt ndërtimit të algoritmeve që mund të formonin ekipe agjentësh, të automatizonin negociatat dhe të përcaktonin besueshmërinë e agjentëve.

Sot, elementet e nevojshme për ndërtimin e sistemeve të IA-së me shumë agjentë dhe në shkallë të gjerë po vendosen njëri pas tjetrit. Agjentët modernë të IA-së mund të përdorin mjete kompjuterike, të kenë qasje në informacion, të shkruajnë dhe të ekzekutojnë kode, të komunikojnë me sisteme të tjera dhe të veprojnë për periudha të gjata kohore.

Le të marrim si shembull një zinxhir furnizimi. Një agjent i IA-së mund të përfaqësojë një prodhues që përpiqet të sigurojë pjesët përbërëse; një tjetër mund të përfaqësojë një furnizues që synon të maksimizojë të ardhurat e veta. Agjentë të tjerë mund të menaxhojnë transportin, inventarin dhe magazinat. Secili prej tyre mund të jetë duke bërë pikërisht atë për të cilën është projektuar. Por pyetja e rëndësishme është nëse sistemi që krijojnë së bashku sillet në mënyrë të arsyeshme.

Ky ndryshim ofron përfitime të jashtëzakonshme të mundshme, por rrit edhe rreziqet. Në një eksperiment të kohëve të fundit, ku u përfshinë OpenAI dhe platforma teknologjike Hugging Face, mijëra agjentë bashkëpunues shkëmbyen dhjetëra mijëra mesazhe dhe arritën t'i anashkalonin kontrollet e sigurisë, duke i dobësuar qëllimisht, të krijuara për t'i mbajtur nën kontroll.

Hollësitë e një eksperimenti të vetëm kanë më pak rëndësi sesa paralajmërimi më i gjerë. Kur sistemet e IA-së ndërveprojnë, sjellja e kolektivit mund të jetë më e vështirë për t'u parashikuar sesa sjellja e secilit sistem më vete. Kjo duhet të na bëjë të kujdesshëm, por jo të na shtyjë t'i braktisim mjetet dhe punën tonë.

Përkundrazi, duhet ta ndryshojmë mënyrën e të menduarit: të kalojmë nga ndërtimi i makinave inteligjente te ndërtimi i shoqërive inteligjente.

Në çastin kur agjentët mund të bashkëpunojnë, të konkurrojnë dhe t'i zgjidhin konfliktet me njëri-tjetrin, nuk kemi më të bëjmë me makina të izoluara, kemi të bëjmë me një shoqëri. Prandaj, kufiri i ardhshëm nuk është inteligjenca artificiale, por shoqëritë artificiale.

## Një rol i rëndësishëm për njerëzit

Ne e dimë tashmë se vetëm inteligjenca nuk mjafton për ta bërë një shoqëri të funksionojë. Shoqëritë njerëzore varen nga rregullat, institucionet, stimujt, normat dhe mekanizmat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Edhe shoqëritë e IA-së do të kenë nevojë për të barasvlershmet e tyre.

Kush mban përgjegjësi kur dy agjentë marrin një vendim të gabuar? Çfarë ndodh kur interesat e agjentëve të ndryshëm përplasen? Kush i vendos rregullat? Dhe kush e ka fuqinë për t'i ndryshuar ato? Këto nuk janë vetëm çështje teknike; janë pyetje që lidhen me ekonominë, ligjin, politikën dhe shoqërinë.

Ato tregojnë gjithashtu se njerëzit do të kenë një rol të rëndësishëm. E ardhmja më e dobishme nuk ka të ngjarë të jetë ajo në të cilën IA-ja thjesht i zëvendëson njerëzit. Edhe pse në disa raste zëvendësimi pa dyshim do të ndodhë, besoj se skenari më i zakonshëm do të jetë ai ku njerëzit dhe agjentët punojnë së bashku, duke bërë secili atë që di të bëjë më mirë.

Njerëzit sjellin gjykimin, përvojën, vlerat, kuptimin e kontekstit dhe përgjegjshmërinë. Agjentët sjellin shpejtësinë, këmbënguljen, shkallën e veprimit dhe aftësinë për të përpunuar sasi të jashtëzakonshme informacioni.

Synimi nuk duhet të jetë krijimi i makinave që i bëjnë njerëzit të panevojshëm. Duhet të jetë krijimi i sistemeve ku njerëzit dhe makinat mund të arrijnë gjëra që asnjëra palë nuk mund t'i arrijë e vetme.

Por një e ardhme e tillë kërkon më shumë sesa thjesht modele më të mira të IA-së. Ajo kërkon besim dhe transparencë rreth veprimeve të agjentëve, mbrojtje të fortë të privatësisë dhe përcaktim të qartë të përgjegjësive.

Ajo do të kërkojë gjithashtu që shoqëritë dhe qeveritë të vendosin se si duhet të rregullohen këto sisteme, kur sjellja më e rëndësishme mund të mos burojë nga një zhvillues i vetëm i IA-së, por nga ndërveprimet mes sistemeve të krijuara nga shumë organizata të ndryshme.

Dekada e fundit e inteligjencës artificiale është përcaktuar nga gara për të ndërtuar sisteme më inteligjente. Besoj se dekada e ardhshme do të përcaktohet nga një sfidë tjetër: të garantojmë që miliona sisteme autonome të mund të punojnë së bashku në mënyrë të sigurt, të drejtë dhe të efektshme.

E ardhmja e inteligjencës artificiale nuk do të përcaktohet vetëm nga inteligjenca e agjentëve individualë, ajo do të përcaktohet nga shoqëritë që ata krijojnë. Dhe shoqëritë, siç e dimë tepër mirë ne njerëzit, janë shumë më të vështira për t'u qeverisur sesa individët. / The Conversation – Bota.al

# EUROPA NUK E DI MË ÇFARË ËSHTË

Nga Anton JÄGER,
The New York Times



Historiani Erik Hobsbaum nuk ishte aspak miqësor ndaj nacionalizmit.
Një fëmijë hebre i rritur në rrënojat e perandorive gjermane dhe asaj austro-hungareze, ai kishte një dyshim instinktiv ndaj çdo pretendimi përkatësie kombëtare. Megjithatë, teksa një falangë partish të reja nacionaliste hynë në parlamentet e shteteve europiane në fillimm të viteve 1990-të, me pretendimin se emigracioni përbëntë një kërcënim vdekjeprurës për komunitetet e tyre, Hobsbaum ofroi një interpretim befasues. Tërheqja ndaj politikave anti-migratore, spekuloi ai, nuk kishte të bënte dhe aq me ndojë ndjesi krenarie kombëtare, se sa me aftësinë e tyre për të mbuluar një boshllëk në zemër të kuptimit që europianët kishin për veten e tyre. "Nuk kishte mbetur asnjë mënyrë tjetër për të identifikuar identitetin e përbashkët," shkruante ai, "veçse duke përkufizuar të huajt që nuk ishin pjesë e tij."
Fjalët mbartin një rezonancë të pazakontë për Europën sot. Kur kanë kaluar më shume se gjashtë javë nga momenti kur dhjetëra mijëra emigrant kaluan në enklavën spanjolle të Ceutas, me shpresën se do mund të hynin në Europë, emigracioni vazhdon të dominojë debatin në continent. Reagimi më i shpeshtë në shumicën e kryeqyteteve europiane ka qenë të kritikojnë Spanjën – politika relativisht bujare e së cilës ndaj emigracionit shihet si përgjegjëse për atë që ndodhi – ndërsa premtohen kufij më të fortë. Me mijëra njerëz ende në çadra në Ceuta dhe Kryeministrin Pedro Sançez në vështirësi për të kontrolluar pasojat, subjekti nuk duket se do të zbehet së shpejti.
Por qartësisht debati shkon shumë përtej çështjes së emigrantëve. Ndonëse sondazhet tregojnë se zgjedhësit europianë janë thellësisht të interesuar për problemin e emigracionit dhe duan ta shohin të adresohet, shqetësime të tilla e tejkalojnë realitetin objektiv. Kështu, tema është kthyer në një prizëm përmes të cilit shihen gjithë problemet e kontinentit, një lloj kalidoskopi i dobishëm pakënaqësish. Problemet e një botëvështrimi të tillë janë të pafundme. Megjithatë, ka një arsye më të thellë, përtej prurjeve të vazhdueshme të emigrantëve, në lidhje me fiksimin e mbarë kontinentit me të huajt: Europa nuk e di më se çfarë është.
Në debatet europiane emigracioni nuk paraqitet më si një problem që duhet manaxhuar. Në vend të kësaj, ai tashmë shihet si përgjegjës për një sërë problemesh, nga dobësimi i shërbimeve sociale tek mosrritja e pagave dhe krimi. Sipas politikanit holandez të ekstremit të djathtë, Geert Wilders, kriza e strehimit në vend dhe nivelet e borxhit shpjegohen më së miri nga fluksi i të huajve. Por një mendësi e tillë nuk kufizohet më vetëm tek esktremet. Në Gjermani, për shembull, qeveria e koalicionit e Kancelarit Friedrich Merz ia ka atribuuar të huajve rrënimin e shumë qyteteve në vend.
Përpjekjet për të verifikuar vërtetësinë e pretendimeve të tilla – deklarimi se efektet e emigracionit nuk janë të qarta, ose paralajmërimi se një continent në plakje ka nevojë për prurje të reja – nuk e kapin thelbin e problemit. Kërkimet tregojnë se bastionet më të forta të së djathtës ekstreme janë në rajone ku ka pak emigrant, siç është rasti i landit të Saxony-Anhalt, ku partia Alternativa për Gjermaninë sapo shënoi një fitore të madhe. Frikërat e europianëve rreth emigracionit sa vjen dhe shfaqen më hapur, një lloj rruge e shkurtër përmes së cilës mund të kuptojnë krizat e mbivendosura të kontinentit. Kjo mënyrë të menduari do të vazhdojë të mbajë të zënë mendjen europiane për një të ardhme të konsiderueshme.
Arsyeja e parë e kësaj është e jashtme. Pasojat e pabarazisë globale ishin mëse të dukshme qysh në kohën e Hobsbaumit. Në vitet '90-të, ai vuri në dukje se si Europa "po rrethohej nga shtete të varfëra me ushtri të rinjsh që luftojnë për punë modeste në botën e pasur, të cilat i bëjnë njerëzit të pasur me standartet e El Salvadorit apo Marokut." Konkluzioni i tij ishte parashikues: "Këto fërkime do të jenë një faktor madhor në politikë, atë kombëtare apo botërore, përgjatë dekadave të ardhshme."
Dhe me të vërtetë, këto tensione vetëm janë thelluar. Edhe pse pabarazia globale teknikisht ka rënë në 30 vitet e shkuara, rënia mund t'i atribuuohet kryesisht një vendi të vetëm: Kinës. Përgjithësisht, hendeku i standardeve të jetesës mes Perëndimit dhe pjesës tjetër të botës mbetet tejet i thellë, një fakt kokfortë i politikës botërore i përkeqësuar nga konfliktet rajonale. Së fundi ka fituar një vizibilitet shqetësues në ekranet e smartfoneve, tanimë të kudondodhura në botën në zhvillim.
Arsyeja e dytë është e brendshme. I ndërtuar si një treg i përbashkët para se të merrte trajtën e një shteti, Bashkimi Europian ka patur gjithmonë vështirësi të artikulojë se çfarë përfaqëson. Në fund të viteve '90-të, problemi u shfaq në dizenjimin e kartëmonedhave që do të përbënin valutën e re të unionit. Në fund, Euro u dekorua me forma abstrakte si harqet dhe akuaduktet, në vend të personazheve të njohura të historisë së Europës. Për disa studiues, kjo tregoi se unioni ishte mbi të gjitha një konfederatë konsumatorësh.
Vitet e fundit, unioni ka nisur një mision për të përkufizuar shtëpinë e vet të përbashkët, siç e quan Presidentja e Komisionit Europian, Ursula von der Leyen. Së bashkum me drejtuesit e studimeve europiane, krahu ekzekutiv i bllokut po financon iniciativa që syonjnë fuqizimin e sensit të identitetit europian. Një prej këtyre ishte një fushatë goxha e marketuar nga komisioni, e quajtur "Mbro atë që ka rëndësi." Aty, qytetarët inkurajoheshin të vlerësonin parimet themeluese të unionit, si "fjalën e lirë," "shkencën e lirë" dhe "shtypin e lirë." Madje, edhe kartëmonedhat pritet të pësojnë ndryshime.
Këto përpjekje janë pa dyshim atraktive për disa nga kufijtë e pushtuar të kontinentit, si Ukraina dhe Gjeorgjia, ku të rinj të arsimuar shohin ende një premtim të madh tek bashkimi me Europën. Megjithatë, mbetet e paqartë se sa larg mund të shkojnë fushata të tilla. Një sërë krizash – kryesisht ekonomike, por edhe kulturore e sociale – e ka bërë argumentin pro bashkimit edhe më sfidues. Në të njëjtën kohë, transformimi i shumë shteteve europiane në ekonomi turizmi, vetëm sa e ka përkeqësuar çorientimin.
Kjo pasiguri rreth karakterit dhe të ardhmes së unionit është dukshëm, e ndoshta ironikisht, më e perceptueshme te ekstremi i djathtë. Një nga vendet e preferuara të Zotit Wilders në Holandë është Efteling, pylli i përrallave në jug të vendit. Ky park tematik, i mbushur me xhuxhë, dragonj dhe të tjera figura nga përrallat për fëmijë, nuk përbën ndonjë shembull të folklorit lokal, por një botë imagjinare krejtësisht jashtë historisë. Dashuria e ekstremit të djathtë për "Zotin e Unazave" është tregues i të njëjtës marrëdhënie fantastike të tyre me realitetin.
Ndoshta nuk duhet pritur koherencë politike nga një grup divers prej 450 milionë njerëzish që nuk kanë një shtet apo gjuhë të vetme. Megjithatë, nacionalizmi në nivel shtetesh mbetet i brishtë, i varur nga gogoli i emigracionit. Të paaftë për të mposhtur në mënyrë sistematike pushtetin e Brukselit, ekstremi i djathtë europian i ka ngulur kthetrat te argumentet banale anti emigracion, për një qëndrim opozitar aty ku nuk ka më një të tillë. Tek e fundit, qendra dhe e djathta ekstreme kanë arritur një consensus rreth kontrollit më strikt kufitar dhe përpjekjeve për deportime.
Rezultati i ngjan më tepër një lloj gjëegjëze. Emigracioni shihet praktikisht nga të gjitha palët si një kërcënim ndaj identitetit europian. Megjithatë, në shekullin e 21-të, mbetet e paqartë së ku ekzaktësisht konsiston ky identitet. Jo më selia e perandorive botërore, kur ka humbur fronin e hegjemonit global, kontinenti ngjet njëkohësisht prestigjioz dhe provincial: një fuqi e madhe kulturore që po vuan nga margjinalizimi gjeopolitik. Europianizmi qytetar, me gjithë përpjekjet e mëdha të komisionit, do të jetë një antidot i dobët për këto lloj sëmundjesh. Në vend të kësaj, do i kthehet emigracionit për të mbushur zbrazëtinë në qendër të imazhit që Europa ka për veten.




Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

## Prishtina diskuton me Izraelin për sigurinë dhe gatishmërinë për Lojërat Mesdhetare 2030

PRISHTINË, 15 SHTATOR - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka bërë me dije se në Odën e Kryeqytetit është diskutuar për mundësitë e bashkëpunimit me Izraelin në kuadër të përgatitjeve për organizimin e Lojërave Mesdhetare "Prishtina 2030".
Rama ka treguar se në takimin me ambasadoren e Izraelit në Kosovë, Tamar Ziv, dhe delegacionin e ekspertëve izraelitë, vëmendje e veçantë i është kushtuar sigurisë, gatishmërisë operacionale, menaxhimit të emergjencave dhe forcimit të reziliencës. Sipas Ramës, gjatë takimit është diskutuar edhe për përdorimin e të dhënave dhe inteligjencës artificiale në organizimin dhe menaxhimin e ngjarjeve të mëdha ndërkombëtare.
"Kryeqyteti vlerëson dhe mirëpret çdo bashkëpunim ndërkombëtar që sjell dije, përvojë dhe mundësi të reja për zhvillim, të ndërtuar mbi respektin e ndërsjellë dhe partneritetin e sinqertë", ka shkruar Rama në rrjetet sociale.



# MALISHEVA FITON BINDSHËM NË PODUJEVË, DUKAGJINI BARAZON ME BALLKANIN



PRISHTINË, 15 SHTATOR - Malisheva ka regjistruar fitore bindëse ndaj Llapit në stadiumin "Zahir Pajaziti", në kuadër të javës së 6 në AlbiMall Superligë, me rezultat 4:0. Skuadra mysafire e ka zhbllokuar rezultatin në minutën e 41-të, kur Vusal Isgandarli ka realizuar për 1:0. Goli është verifikuar përmes VAR-it.
Malisheva ka vazhduar me ritëm të lartë edhe në pjesën e dytë. Në minutën e 57, pas rishikimit të situatës me VAR, Malishevës i është akorduar një penallti, ndërsa Xhemal Ibishi ishte i saktë nga pika e bardhë për 2:0.
Vetëm tre minuta më vonë Lorent Talla e ka dërguar topin në rrjetë për 3:0, ndërsa rezultatin përfundimtar e ka vendosur Mark Bushaj në minutën e 84-t.
Për Llapin kjo ishte humbja e pestë në gjashtë ndeshje, ndërsa Malisheva me këtë fitore vazhdon të mbajë ritëm të lartë në pjesën e sipërme të tabelës.
Në ndeshjen tjetër në Suharekë, Ballkani dhe Dukagjini kanë zhvilluar një ndeshje të fortë, por në fund asnjëra skuadër nuk ka arritur ta gjejë rrugën e rrjetës. Takimi ka përfunduar 0:0, me të dyja skuadrat që kanë krijuar mundësi shënimi, por ka munguar konkretizimi në momentet vendimtare.
Dukagjini që ende nuk ka pësuar humbje, ka regjistruar kështu barazimin e tretë të sezonit, krahas tri fitoreve, dhe me 12 pikë renditet në pozitën e tretë. Ballkani, ndërkohë, ka regjistruar barazimin e dytë dhe ka tri fitore dhe dy humbje, duke mbledhur 10 pikë në vendin e pestë.

# SUPERLIGA E KOSOVËS NË BASKETBOLL NIS NË FUNDJAVË

PRISHTINË, 15 SHTATOR - Përkundër faktit se finalja e Superkupës së Kosovës në basketboll është shtyrë për dy javë, sezoni 2026/27 i Superligës do të nisë këtë fundjavë. Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) ka bërë me dije se gjithçka është gati për fillimin e sezonit të ri, ku edhe këtë edicion do të garojnë tetë skuadra.
Zyrtarisht, Superliga do të nisë të shtunën, më 19 shtator, kur janë paraparë të zhvillohen dy ndeshje. Sigal Prishtina - Peja dhe Rahoveci 029 - Trepça janë dy përballjet e xhiros së parë, të cilat do të zhvillohen nga ora 17:00, përkatësisht 19:00.
Ndërkohë, të dielën, në të njëjtat orare, do të zhvillohen edhe dy ndeshjet e tjera të xhiros së parë. Bashkimi do të përballet me Golden Eagle Yllin, ndërsa Bora do të luajë ndaj Vëllaznimit.
FBK-ja ditë më parë ka njoftuar se finalja e Superkupës së Kosovës, e paraparë të zhvillohej të mërkurën, është shtyrë për datën 29 ose 30 shtator. Në finalen e Superkupës do të përballen Trepça dhe Bashkimi.



# ATALANTA SYNON ZHEGROVËN NË JANAR



TORINO, 15 SHKURT - Dy golat e parë të Edon Zhegrovës me Juventusin kanë përmirësuar dukshëm situatën e tij te skuadra italiane.
